



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 586 Prot

Tiranë, më 30.01. 2015

U DHËZIM

Nr 56 Datë 29/01/2015

**Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 5.11.2014  
“Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga  
skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 5.11.2014 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të Urdhërit të Ministrit Nr 534 datë 4.12.2014 “Për miratimin e statutit të Qendrave Shëndetësore”,

**UDHËZOJ:**

1. Ministri i Shëndetësisë miraton strukturën analitike të Qendrës Shëndetësore dhe çdo ndryshim të saj, bazuar në raportin e njësisë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë, pas propozimit të bërë nga drejtori i Qendrës Shëndetësore.
2. Propozimet për ndryshime në strukturë duhet të shoqërohen me relacionin përkatës për domosdoshmërinë e kryerjes së tyre.
3. Struktura e miratuar i dërgohet për zbatim QSH dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe njoftohen DSHP/DRSH/ASHR.
4. Punësimi i profesionistëve të shëndetësisë, mjekë dhe infermierë në Qendrat Shëndetësore miratohet nga Ministri i Shëndetësisë.
5. Drejtori i Qendrës Shëndetësore përzgjidhet sipas kritereve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe emërohet prej tij.
6. Ministria e Shëndetësisë organizon procedurën e konkurrimit për vendet vakante në nivel rajonal çdo tre muaj.
7. Me krijimin e vendit vakant, drejtori i Qendrës Shëndetësore paraqet për çdo rast me shkresë zyrtare informacionin për vendet vakante për mjekë dhe infermierë pranë DRSH\DSHP\ASHR.

Bulevardi “Bajram Curri”, Nr.1 Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax: ++355 4362937, [www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al)



8. DSHP/DRSH/ASHR pas përfundimit të çdo tremujori, paraqesin pranë njësisë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda datës 20 të muajit pasardhës, të dhënat për vendet vakante që parashikohen për tremujorin pasardhës.
9. Në rastet kur krijimi i vendeve vakante ndodh për shkaqe të paparashikuara, drejtori i Qendrës Shëndetësore njofton njëkohësisht pranë DRSH\DSHP\ASHR dhe propozon pranë njësisë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë emërimin e përkohshëm të një kandidati. Në rastet kur vendi vakant i përket pozicionit të punës “drejtor” i qendrës shëndetësore, propozimi i jo më pak se dy kandidaturave pranë njësisë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë bëhet nga drejtuesi i DSHP/DRSH/ASHR.
10. Ministria e Shëndetësisë miraton emërimin e përkohshëm në vendin vakant të kandidaturave të propozuara nga njësia përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit dhe emërimit nga Ministri i Shëndetësisë të kandidatit fitues për punësim të përhershëm.
11. Ministria e Shëndetësisë publikon në portalin zyrtar dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik vendet vakante të grupuara sipas qarqeve, procedurën për aplikim, kriteret që duhet të plotësojë kandidati për çdo kategori vendi vakant, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.
12. Konkurrimi si rregull bëhet vetëm me dosje. Për ato raste kur konkurrimi me dosje mund të jetë i pamjaftueshëm për përzgjedhjen e kandidaturës fituese Ministri i Shëndetësisë mund të vendosë kryerjen e procedurave shtesë.
13. Dokumentacioni i publikuar në portalin zyrtar të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, pasi plotësohet, paraqitet pranë zyrës së protokollit të Ministrisë së Shëndetësisë, brenda afatit të parashikuar në njoftim. Formulari i Aplikimit dhe Fletë Inventari i dokumentacionit të dorëzuar, sipas modelit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, shkarkohen nga portali zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë. Më pas nënshkruhen nga aplikanti dhe i bashkëngjiten praktikës së aplikimit.
14. Dokumentacioni administrohet nga njësia përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe pasqyrohet në tabelën përmbledhëse me proces-verbal. Njëkohësisht hartohet lista e aplikantëve me dokumentacion të plotë. Praktikant jo të plota të paraqitura nga aplikantët skualifikohen. Afati i përgatitjes së dokumentacionit të plotë për zhvillimin e konkurrimit do të jetë jo më vonë se 15 ditë nga data limit për dorëzimin e tij.
15. Me përmbushjen e këtij afati, Ministri i Shëndetësisë miraton komisionin “ad-hoc” për vlerësimin e dosjeve.
16. Komisioni “ad-hoc” brenda një periudhe prej 5 ditëve pune, vlerëson kandidatët në bazë qarku sipas kriterëve bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe përpilon proces-verbalin me emrat e kandidatëve, të renditur sipas pikëve.



17. Pas përfundimit të proces-verbalit, komisioni “ad hoc” i paraqet menjëherë Ministrit të Shëndetësisë propozimet me emrat e fituesve për vendet vakante.
18. Pas miratimit të listës së kandidatëve fitues nga Ministri i Shëndetësisë, autorizohen drejtuesit e Qendrave Shëndetësore të interesuara për lidhjen e kontratës.
19. Kontratat e punës për personelin të Qendrës Shëndetësore bazohen në dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.
20. Dokumentacioni i personelit të Qendrës Shëndetësore administrohet pranë zyrave të DRSH\DSHP\ASHR dhe një kopje administrohet pranë Qendrës Shëndetësore.
21. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

  
**MINISTRI**  
**ILIR BEQAJ**

